



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 1.3.2025

Nr: 216

Ora: 17:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË BASHKISË
ELBASAN PËR PERIUdhËN 16 SHKURT-22 SHKURT 2025**

Sot, më datë 1.3.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBEKT: Bashkia Elbasan

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Bashkisë Elbasan për periudhën 16 shkurt-22 shkurt 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 16 shkurt-22 shkurt 2025, Bashkia Elbasan ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 4 (katër) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. "Inspektim punimesh në lidhje me shkollën Tregan", raportuar në datë 16.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 20.02.2025.
2. "Mbjellje pemësh në Tregan", raportuar në datë 16.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 20.02.2025.
3. "Inspektim të punimeve në rrugën Tregan", raportuar më datë 16.05.2025 për t'u zhvilluar më datë 20.02.2025.

Data: 1.3.2025 Nr: 216
Ora: 17:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Elbasan për periudhën 16 shkurt-22 shkurt 2025”

4. “Takim me blektorët e zonës të Njësisë Administrative Tregan”, raportuar më datë 16.02.2025 për t’u zhvilluar më datë 20.02.2025.

Nëpërmjet postës elektronike, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Elbasan një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Elbasan ka dërguar pretendimet, duke sqaruar si vijon: *“Ju bëj me dije se nga ana ime ka qenë një gabim teknik. Në raportin e gjetjeve të datës 25.2.2025 keni konstatuar për Bashkinë Elbasan 4 veprimtari të raportuara jashtë afatit për datat e raportimit 16 shkurt dhe kryerjes së aktiviteteve datat 20 shkurt. Ju bëjmë me dije se kemi interpretuar se jemi në përmbushje të afatit 5 ditor pasi nëse i referohemi pikës 3, të nenit 5, të Vendimit nr. 9, dt 24.12.2020, nuk është e përcaktuar nëse përlllogaritja e afatit bëhet që në ditën e raportimit apo të nesërmen e saj. Për Bashkinë Elbasan jam i vetmi person përgjegjës për të raportuar aktivitetet e institucionit tonë në NRI dhe ju bëj me dije se në datë 17 Shkurt-21 Shkurt kam qenë me leje të zakonshme dhe nuk kam pasur mundësi të aksesohem në systemin NRI për të parë nëse kishim të bënim me veprimtari të ndaluara në mënyrë që të merrnim masat e nevojshme. Për sa shpjegova më sipër në lidhje me arsyet dhe rrethanat e raportimit në NRI kërkoj nga ana juaj që të vlerësohen dhe të merren parasysht”.*

Për sa më sipër, pasi u njoha me arsyet e paraqitura nga ana e personit përgjegjës për raportimet, mirëkuptohet situata dhe vlerësohet se është një gabim njerëzor në interpretimin e dispozitave ligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Elbasan.
2. Ky vendim njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI